



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 06.02. 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosiloviç, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Ismet Beqiri, Fatmir Xhelili, Ramiz Kelmendi, Muharrem Nitaj dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Deputetët të tjerë, pjesëmarrës në takim: Shemsi Syla dhe Milaim Zeka.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Betim Musliu-KDI, Plator Avdiu-QKSS, Mentor Vrajolli-QKSS, Agnesa Haxhiu-KDI, Dhurata Kryeziu-OSBE, Burim Tahiri- Institucioni i Avokatit të Popullit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, e mbajtur më datë 15.12.2017;
3. Raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme, z. Flamur Sefaj, rreth zhvillimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, fillimisht njoftoi anëtarët e komisionit, që për arsye shëndetësore, z. Flamur Sefaj, ministër i Punëve të Brendshme, nuk mund të raportojë në komision rreth zhvillimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës. Gjithashtu, propozoi që në këtë takim të formohen grupet punuese për Projektligjin nr. 06/L-026 për azil dhe Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të huajt.

Rexhep Selimi, theksoi se e mirëkupton mungesën e ministrit, por mund të shqyrtohej kjo çështje, pa hyrë në detaje. Gjithashtu, falënderoi mediat për pasqyrimin e problematikës dhe zhvillimeve në IPK. Propozoi formimin e grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për IPK-në, i cili do të ndihmonte më pas në ndërmarrjen e masave nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Fatmir Xhelili, lidhur me zhvillimet në IPK, theksoi se ka pasur zhvillime jo konform ligjit, siç ka qenë procesi i rekrutimit. Gjithashtu, konsideroi se është e rëndësishme të trajtohet edhe mënyra e menaxhimit të Inspektoratit Policor të Kosovës, bazuar në Ligjin për IPK-në dhe mënyrën organizative të IPK-së, pasi që ky institucion është mekanizëm i rëndësishëm në hulumtimin e aktiviteteve joligjore në polici. Me vendimin e kryshefit të IPK-së, për ndryshimin e strukturës organizative, ka pasur rënie dhe është shndërruar në një organizatë që ka filluar të merret më shumë me veten. Theksoi se është kundër formimit të grupit punues në këtë fazë, duke propozuar që në një fazë të mëvonshme, të formohet grupi punues, pasi që nëse formohet tani, do të interferonte në punën e IPK-së.

Rexhep Selimi, lidhur me formimin e grupit punues, theksoi se komisioni është kompetent dhe se tashmë janë identifikuar shkeljet ligjore në IPK, duke shkaktuar vepra penale. Gjithashtu, theksoi se mbikëqyrja e ligjit nuk do të pengonte prokurorinë. Më tej, theksoi se ky institucion ka pasur probleme në vazhdimësi, duke kërkuar formimin e grupit punues që do të dilnin me rekomandime, ndoshta edhe për ndryshimi dhe plotësimin e Ligjit për IPK-në, që propozoi z. Xhelili.

Muharrem Nitaj, lidhur me zhvillimet në IPK dhe me të gjeturat e raportit të Avokatit të Popullit, e konsideroi serioze. Propozoi që grupi punues mos të formohet, pa dëgjuar edhe raportimin e ministrit të Punëve të Brendshme. Gjithashtu, propozoi që të marrë vendim për një takim urgjent me ministrin e Punëve të Brendshme dhe më pas formimin e ndonjë grupi punues.

Xhelal Sveçla, lidhur me zhvillimet në IPK, theksoi se janë zhvillime dhe shkelje serioze në kundërshtim me ligjin, ku janë disa zyrtarë të lartë shkelës të ligjit dhe disa institucione, të përfshirë në këtë çështje. Prandaj e konsideroi si të rëndësishme, që komisioni të kryejë obligimin për mbikëqyrjen e këtij institucioni, duke shtuar se është urgjente formimi i grupit

punues për mbikëqyrjen e Ligjit për IPK-në dhe të bashkërendohet me ministrin e Punëve të Brendshme dhe me IPK-në.

Fatmir Xhelili, lidhur me zhvillimet në IPK, theksoi se procesi i rekrutimit, ndoshta duket më pak i rëndësishëm, krahasuar me aspektin organizativ të IPK-së, përfshirjen e prokurorisë, prandaj në fazat e ardhshme, propozoi që të shikohet zbatimi i ligjshmërisë, duke u formuar grupi punues, duke shtuar se komisioni nuk mund të hetojë, pasi janë institucionet tjera dhe më pas bëhet monitorim i institucioneve në zbatimin e ligjit.

Rexhep Selimi, propozoi për formimin e një grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për IPK-në dhe jo komision hetimor parlamentar. Gjithashtu, përmendi faktin që pezullimi i detyrës nga ana e kryeshefit të IPK-së, tashmë i suspenduar, ka qenë joligjor, po ashtu edhe emërimet që kanë ndodhur në IPK dhe shuarja e disa departamenteve është parë si problematike.

Ismet Beqiri, lidhur me propozimin për formimin e grupit punues, theksoi se e konsideron më të arsyeshme, që pas raportimit të ministrit, të bëhet një gjë e tillë dhe e konsideroi si përgjegjësi e gjithë komisionit, jo vetëm të grupit punues për të mbikëqyrur ligjshmërinë e punës së IPK-së, duke kërkuar që edhe institucionet tjera, zbatuese të ligjit, të jenë përgjegjëse.

Rexhep Selimi, propozimin për formimin e grupit punues e konsideroi si një obligim, i cili është i përshkruar edhe në doracakun e Kuvendit të Kosovës për funksionimin e komisioneve parlamentare. Gjithashtu, theksoi se kjo praktikë ka qenë edhe në legjislaturën IV dhe V, ku është formuar grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për IPK-në

Kryetari, theksoi se e vlerëson si të arsyeshme, që pas raportimit të ministrit, të bëhet formimi i grupit punues, duke shtuar se ka udhëzime administrative, që janë në kundërshtim me ligjin.

Drita Millaku, sa i përket zhvillimeve në IPK, theksoi se formimi i grupit punues nuk i pengon institucionet tjera, që mund të jenë duke u marrë me zhvillimet në IPK. Për këtë arsye, propozoi formimin e grupit punues monitorues dhe të gjeturat mund të shërbenin edhe për institucionet tjera.

Muharrem Nitaj, lidhur me formimin e grupit punës e konsideroi si të ngutshëm që të formohet sot, pa dëgjuar edhe ministrin e Punëve të Brendshme, që të raportojë për këtë çështje, duke shtuar se pas një jave, mund të formohet dhe mos të këmbëngulet që sot të krijohet.

Zoran Mojsilović, theksoi se fillimisht do të ishte më mirë të pritet raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme dhe më pas të formohet grupi punues, për këtë çështje. Gjithashtu, theksoi se ndoshta raportimi nga ana ministrit është në rregull dhe nuk do të ketë nevojë për veprime shtesë.

Xhelal Sveçla, e konsideroi si të nevojshme formimin e grupit punues, i cili do të dalë me një raport dhe do të vlerësonte, nëse po zbatohet Ligji për IPK-në, ndërsa sa i përket raportimit të ministrit të Punëve të Brendshme, nuk e konsideroi si shumë të nevojshëm në këtë takim dhe nuk do të pengonte punën e grupit punues, pasi që shkeljet janë të mëdha, në kuadër të IPK-së.

Ismet Beqiri, propozoi që pas takimit me ministrin, komisioni të diskutojë se cila është forma më e mirë për të mbikëqyrur zhvillimet në IPK.

Ramiz Kelmendi, gjendjen në IPK e konsideroi si serioze, për procesin e rekrutimit, ku pas përfundimit të fazave të rekrutimit, nga ministri është pezulluar procesi për fillimin e punës së tyre. Për këtë arsye e konsideroi të nevojshëm raportimin ministrit të Punëve të Brendshme.

Fatmir Xhelili, theksoi se edhe para daljes së raportimeve në media dhe raportit të Avokatit të Popullit, ka qenë në plan nga vetë z. Xhelili dhe partia që i përket (PDK), që të ngrihet çështja rreth zhvillimeve dhe parregullsive në IPK, por propozoi që formimi i grupit punues, të shtyhet për një fazë të mëvonshme, duke mos interferuar tek institucionet tjera.

Rexhep Selimi, e konsideroi të nevojshëm formimin e grupit punues, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, mori këtë:

VENDIM

Në takimin e sotëm nuk do të diskutohet për zhvillimet në Inspektoratit Policor të Kosovës, në mungesë të ministrit të Punëve të Brendshme, z. Flamur Sefaj.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, hiqet pika e rendit të ditës: Raportimi i ministrit të Punëve të Brendshme, z. Flamur Sefaj, rreth zhvillimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës. Ndërsa, plotësohet me një pikë të re: Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 06/L-026 për azil dhe Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-219 për të huajt.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, e mbajtur më datë 15.12.2017

Procesverbali u miratua me vërejtje nga z. Zoran Mojsilović. Në fjalimin e tij, shprehja “dialogu Kosovë-Serbi”, zëvendësohet me “dialogu Prishtinë-Beograd”.

3. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 06/L-026 për azil dhe Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt

Kryetari propozoi që të formohen grupet punuese për Projektligjin për azil dhe për të huajt. Gjithashtu, theksoi se deputeti Ismajl Kurteshi ka shprehur interesimin të jetë pjesë e grupit punues.

Rexhep Selimi, propozoi formimin e një grupi punues, që do të shqyrtonte të dy projektligjet.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime, nxori këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për azil dhe për të huajt, me këtë përbërje: Fatmir Xhelili, kryesues, Rexhep Selimi, Xhelal Sveçla, Muharrem Nitaj, Ramiz Kelmendi, Zoran Mojsilović, Bahrim Shabani dhe Ismajl Kurteshi.

4. Të ndryshme

Kryetari njoftoi për vizitën e realizuar në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, ku kanë qenë pjesëmarrës kryetari dhe dy zëvendëskryetarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Gjithashtu, e konsideroi të rëndësishme këtë vizitë dhe ligjëratat në këtë vizitë, ku janë dhënë sugjerime nga ana e tyre. Temat e diskutuara kanë qenë, demarkacioni, çështja e transformimit të FSK-së, si dhe iniciativa për shfuqizimin Gjykatës Speciale.

Rexhep Selimi, e konsideroi këtë vizitë me karakter trajnimi, si nga më të rëndësishmet, e realizuar nga Kuvendi i Kosovës. Kosova ka statusin e vëzhguesit, në kuadër të NATO-s, ku aktualisht quhet raport ndërveprimi, duke e konsideruar si vizitë vetëdijësuese për proceset e ardhshme. Po ashtu, konsideroi se disa nga sugjerimet kanë qenë të pëlqyeshme e disa jo, por temat e trajtuara duhet të reflektojnë në agjendën e punës së komisionit dhe më gjerë. NATO-ja është e përfshirë në procesin e integritimit në strukturat e saj.

Zoran Mojsilović, lidhur me vizatën në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, theksoi se nga kjo vizitë kanë marrë instruksione, këshilla dhe informata, kur të merren hapa politikë për Kosovën. Gjithashtu, shtoi se edhe nikoqirët, edhe delegacioni është ndarë i kënaqur nga kjo vizitë.

Kryetari njoftoi për punëtorinë që do të organizohet me mbështetjen e OSBE-së, për plotësimin e planit të punës për vitin 2018. Punëtoria do të mbahet në Prevallë, më datë 12-13 shkurt dhe propozoi sjelljen e propozimeve konkrete.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala